

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

Ortaku Z. Kostika Koco i biri i Jorgji i datelindjes 30/12/1986, lindur ne Erseke e me banim ne Lagjjen "Pavaresia" Rruga "Gjergj Arianiti" prane shkolles Elite Nr 77 Vlore, qe mbaj letemjofte me nr Personal I61230053B, i cili me cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, mbeshtetur ne inisiativen e lire private, Kodin Civil Shqiptar ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit si dhe ligjit te plotesuar, kerkoj qe te themeloj nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, "Bio Tech Medical SHPK"

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "BioTech Medical SHPK", eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria "Bio Tech Medical SHPK", eshte nje shoqeri tregtare, e themeluar nga ortaku i cili do pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe do mbuloje personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara. Kontributi i ortakeve perben kapitalin e regjistruar te shoqerise. Ortaket gezojne kuoten e tyre ne shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe kane dhene ne kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne Lagjjen "Pavaresia" Rruga "Gjergj Arianiti", prane shkolles Elite Nr 77 Vlore. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te ushtroje Aktivitet si me poshte:

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete: Import-eksport, veprimtari ne fushen e paisjeve mjeksore, sherbimeve mjeksore, Farmaceutike, agrokultures, flores, faunes, konsulenca mjekesore, Import-eksport, tregtim te pajisjeve dhe materialeve me perdorim laboratorik, kite reagente dhe materiale konsumi laboratorik dhe pajisje laboratorike, dhënie me qera e pajisjeve laboratorike, transport mallrash brenda vendit, materialeve te buta, veshje dhe uniforma spitalore per perdorim te perditshem, bar-kafe, agjensi turistike, dhënie makina me qera dhe shitje-blerje moto mjete, makina, konstruksione te te gjitha llojeve, shitje me shumice e pakice veshjesh e konfeksione te ndryshme, sherbime te ndryshme ne fushen e telekomunikacionit dhe informatikes, elektroshtepiake dhe elektrokulturore, bujqesore, blegtorale dhe bime medicinale, lende ndertimi dhe paisje higjeno-sanitare, ne fushen e informatikes, artikuj kancelarie leter printer A4, A5 etj, transport mallra tokesor dhe detar per vete dhe per te trete si dhe cdo aktivitet tjetër i cili nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

*Kostika Koco*  


Neni 5  
Kohezigjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar por jo me pak se 10 vjet duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

KREUII  
KAPITALI

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte ; 100.000 leke (njqindmije) leke , e perbere nga 1 kuote te zoteruar **100%** nga ortaku Kostika Koco me vlere 100.000 leke  
Kapitali i mesiperm eshte nenshkruar dhe shlyer teresisht ne te holla nga dy ortaket e shoqerise .  
Kontributi i ortakeve mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme apo te drejta). Ortaket pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te tretteve deri ne vleren e kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise .

Neni 7  
Transferim i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes , nga casti i kalimit te kuotave, deri ne castin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".  
Rregjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREUII

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8  
Organi Vendimmarres

Ortaket jane organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaket jane organi vendimmarres i shoqerise qe miratojne cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaket, vendosin per ceshtje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise ;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve
- e) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
- f) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;

*Shoqeria KOCO*  


g) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;

Te gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise ;
- b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investimet;
- d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme . Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

#### Neni 9 Administrimi

Administratori i shoqerise eshte Z. Kostika Koco

Data e fillimit te administratorit eshte data e regjistrimit te shoqerise ne QKR.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperseritje. Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim Asambleje te ortakeve te Shoqerise . Administrator i Shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

#### Neni 10 Kompetencat

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarise tregtare te shoqerise , duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga Ortaket
- b) perfaqesoje shoqerine tregtare;
- c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise ;
- d) pergatis dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ti paraqesin keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
- e) Te krijojte nje sistem paralajmerimi ne kohet e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistences se shoqerise;
- dh)Te kryeje regjistrimet dhe te dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise , si parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- f) Te raportojte perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;

Administratori eshte i detyruar te therrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktiviteti i shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri , qe kane vlere me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.


Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te jashtezakonshem.

Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shteterore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve.

Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e tij.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

*Kostika Koco*  


Neni 11  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohezhgatja e parashikuar ne themelimin e tij;
- b) me vendim te ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- h) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- d) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket marrin vendime me shkrim ne te cilin parashikojn menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likujdatorit dhe emertesin shtese " Shoqeri ne likuidim e siper" .

Neni13  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ortaket e shoqerise

Kostika Koco

